



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
Nr. / Br.	32778 / 125
Nr. i fq. / Br. st.	-2-
Data: / Datum:	11.07.2025
VUSHTPRI - VUÇITRN	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtri

**Procesverbali nga dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave Smrekonicë,
Dobërllukë, Pasomë, Bajskë, Sllatinë dhe Tërlllobuq**

Korrik 2025

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik me qytetarë për përgatitjen e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2026, mbajtur me banorët e Këshillit Lokal Smrekonicë, që përfshin fshatrat Smrekonicë, Dobërllukë, Pasomë, Bajskë, Sllatinë dhe Tërlllobuq.

Vendi: Shkolla "Enver Hadri" në Smrekonicë

Ora: 19:30 / Data: 24.06.2025

Të pranishëm nga Komuna ishin Qemajl Hasani, zyrtar në Drejtorinë për Financa, Buxhet dhe Thesar, Besim Demiraj, Drejtor për Inspektime dhe Mirjeta Duraku, zyrtare për Informim.

Qemajl Hasani, kryesues, hapi mbledhjen me qytetarë, ku edhe paraqiti buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2026 dhe projektet e parapara për fshatrat e Këshillit Lokal Smrekonicë.

Gjithashtu, qytetarëve të pranishëm në këtë dëgjim ju është shpërndarë material informues për buxhetin e vitit 2026.

Më pas fjala ka kaluar tek qytetarët pjesëmarrës në këtë takim për të paraqitur kërkesat e tyre.

Blerim Hasani, banor i fshatit Smrekonicë, kërkoi asfaltimin e rrugës "Të bijtë e Alisë", aneks i rrugës "Sofra e UÇK-së", në gjatësi prej 100m.

Bajram Veseli, banor i fshatit Smrekonicë, tha se familja e tij si dhe 7 shtëpi të familjes Veseli qëndrojnë shumë keq me rrjetin primar të kanalizimit me gjatësi 500m.

Driton Veseli, banor i fshatit Smrekonicë, kërkoi që rruga "Nesim Mustafa" të asfaltohet.

Agron Veseli, banor i fshatit Smrekonicë, kërkoi shtrimin e rrugës në zhavor në lagjen Sefedini, afër xhamisë së fshatit.

Driton Berisha, banor i fshatit Smrekonicë, propozoi që të bëhet ndriçimi i rrugës "Agim Hasani", si dhe shtrimi i rrugës së familjes Hasni aneks i kësaj rruge.

Agim Hashimi, kryetar i fshatit Bajskë, paraqiti kërkesat për këtë fshat:

1. Asfaltimi i rrugës "Ramiz Hashimi" në gjatësi prej 250 metrash dhe gjerësi 3 metra.
2. Riasfaltimi i rrugës "Shaban Sadiku" apo rikonstruimi në ato pjesë që janë të dëmtuara.
3. Rregullimi i rrugës "Izet Ismajli" dhe vendosja e së paku katër pengesave për ndalim të shpejtësisë.
4. Shtrimi me zhavorr i rrugës Ka Shtalla në gjatësi prej 250 metrash.
5. Rregullimi i ndriçimit publik në rrugën kryesore të fshatit në gjatësi prej 600 metrash.
6. Rregullimi i një mini-parkut afër autostradës, për lagjen që banon në anën poshtë autostradës, në hapësirën që është pronë publike.

Procesmbajtës:

Qemajl Hasani.



Deçimet Rrethetore - Smrekonicë
24.06.2025, 19^h

-
- Qemal Hasani Q. Hasani
- Agim Hoxhin A. Hoxhin
- BASHKIM SADIKU B. BASHKIM PASOMË
- BAJRAM VESELI B. VESLI Smrekonicë
- IRITON BERISHA I. BERISHA Smrekonicë
- Agron Veseli A. VESLI
- Blerim Hasani B. HASANI Smrekonicë
-